



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:141144

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05482309

P.nr.436/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Q nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.701/2023, të datës 23.06.2023, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 20.03.2024, në të cilin kishin prezantuar prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri dhe i akuzuari B.Q, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 21.03.2024, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Për të akuzuarin B.Q, nga babai H dhe nëna Gj, e lindur I, i lindur me datë....., në Gjilan, ku edhe jeton rruga ..ka të kryer 1 vit të shkollës së mesme, i pa martuar, i punësuar në botën e jashtme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal

Në bazë të nenit 362 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i KPP-ës:

REFUZOHET AKUZA

Sepse me datë me datë 23.04.2023, rreth orës 15:40 minuta, në Gjilan, rruga ...me dashje, e ka përdorur forcën ndaj personit tjetër, të akuzuarit të dytë-të dëmtuarit R.M, në atë mënyrë që pas

një konflikti verbal njëri me tjetrin duke u sharë me fjalë fyese, i akuzuari B sulmon fizikisht R.M mirëpo aty ndërhyjnë dëshmitari E.V, i cili kishte arritur që ti ndaj.

- Me çka kishte për të kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës.

I dëmtuari R.M për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 23.06.2023, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.701/2024, kundër të akuzuarit B.Q nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës dhe të akuzuarit R.M për shkak të veprës penale sulmi në tentativë nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, së bashku me aktakuzën prokuroria ka paraqitur edhe kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, të cilën kërkesë gjykata nuk e kishte aprovuar dhe komfor nenit 492 paragrafi 2 i KPP-ës kishte caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë nuk ishte arritur të sigurohet prezenca e të akuzuarit të dytë R.M me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve, me pëlqimin e tyre dhe në bazë të nenit 35 të KPP-ës kishte marrë aktvendim me të cilin për të akuzuarin R.M për shkak të veprës penale sulmi në tentativë nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës ndërsa shqyrtimit gjyqësor për të akuzuarin B.Q për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës kishte vazhduar në rrjedhën e saj normale ku ishte bërë administrimit i provave personale dhe materiale si dhe palët kishin dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se me provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore e posaçërisht shikimit të video incizimit nga vendi i ngjarjes, analizimit të këtyre provave dhe krahasimit të tyre vijmë në përfundim se në rastin konkret me asnjë provë të vetme nuk arrihet që të argumentohet se fakti se B.Q e ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-së. Nuk ishte kontestuese që ditën kritike tani i akuzuari B.Q ka pasur një mosmarrëveshje me R.Mn mirëpo në veprimet e B.Qt nuk përmbushen elementet themelore të veprës penale të sulmit prandaj duke u bazuar në atë se sipas dispozitave të KPP-së përgjegjësia penale duhet të vërtetohet në mënyrë bindëse ndërsa

në rastin konkret nuk është vërtetuar e njëjta, në mungesë të provave në rastin konkret në kuptim të nenit 362 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-ës tërhiqet nga akuza ndaj tani të akuzuarit B.Q dhe kërkon nga gjykata që të sjell aktgjykim refuzues pasi që vlerëson se përgjegjësia penale duhet të provohet dhe se askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtpërdrejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale prandaj dhe në të drejtën penale vlen parimi in dubio pro reo pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij, në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2 i KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 3 të KPP-ës të dëmtuarin R.M për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata për një gjë të tillë vendosi në bazë të nenit 453 paragrafi 1 i KPP-ës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe meqenëse prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga aktakuza ndaj të akuzuarit B.Q nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës, gjykata komfor nenit 362 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i KPP-ës vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.436/2023, me datë 21.03.2024.

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.